



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 7 nëntor 2012

**Fillimi i projektit Tuining të financuar nga BE-ja: Mbështetje  
për Entin Shtetëror Statistikor-  
Përmirësimi i vendimmarrjes politike përmes statistikave  
(Qendra e BE-së për informim)**

**Fjalim nga  
Ekselencia e tij Z. Aivo Orav  
Shef i delegacionit të BE-së**

**I nderuar Sekretar Shtetëror Z. Andonovski,**

**I nderuar Ambasador Steinaker,**

**E nderuar z-ja. Junker,**

**E nderuar Drejtoreshë z-ja. Novkovska,**

**I nderuar Z. Raupah,**

**Zonja dhe zotërinj,**

Kam kënaqësinë që sot t'ju uroj mirëseardhjen në hapjen zyrtare të projektit Tuining të radhës, i cili financohet nga BE-ja dhe i cili do të mbështesë Entin Shtetëror Statistikor në përforcimin e mëtutjeshëm të kapacitetit dhe në afrimin e përputhjes së statistikave me standardet e BE-së.

Për Bashkimin Evropian, ndihma për **zyrat e statistikave është shumë e rëndësishme në procesin e anëtarësimit**. Jo vetëm që **përputhja e statistikave me standardet evropiane** është një nga kushtet që shtetet kandidate duhet t'i plotësojnë për tu kualifikuar për anëtarësim, por gjithashtu ky është një element kyç për përmirësimin e **bazave të vendimmarrjes nga administrata shtetërore, bizneset dhe qytetarët**. Prezenca e të dhënave statistikore që janë të sakta, të besueshme dhe në kohë të duhur, është shumë e rëndësishme për krijimin e një

pasqyre të qartë rreth ekonomisë, demografisë sociale të shtetit dhe për t'u krahasuar më lehtë në nivel ndërkombëtar. Shërbimet statistikore që janë në gjendje të japin të dhëna të tilla janë shumë të rëndësishme sot, në një kohë kur kushtet ekonomike ndryshojnë shumë shpejt, kur rritja dhe zhvillimi në të ardhmen në çdo fushë të shoqërisë varen nga kombinimi i vendimeve të rëndësishme të marra në kohën e duhur.

Trajtimi si projekt tuining, u jep mundësi ekspertëve nga administrata shtetërore në shtetet kandidatë të punojnë së bashku me homologët e tyre nga shtetet anëtare të BE-së. Ekspertët nga shtetet anëtare të BE-së do të kontribuojnë me përvojën dhe ekspertizën e tyre për të ndihmuar Entin Shtetëror Statistikor në zhvillimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve dhe në përafrimin e tyre me standardet e BE-së.

Ky projekt i dytë tuining i financuar nga BE-ja, i cili i ofrohet Entit Shtetëror Statistikor do të implementohet në bashkëpunim me Zyrën Federale Statistikore nga Gjermania, në partneritet me Statistikat nga Danimarka.

BE-ja është e vendosur për të vazhduar mbështetjen në fushën e statistikave gjatë të ardhmes. Në fund, ju dëshiroj të gjithë pjesëmarrësve në këtë projekt një punë të suksesshme dhe të frytshme!

Ju falenderoj shumë për vëmendjen.